

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Korrupsion dhe shpërdorim detyre, AMP arreston efektivin e Policisë në Durrës! Nisin hetimet për dy të tjerë - Informohu siç duhet
ADRESA	https://radar.al/korrupsion-dhe-shperdorim-detyre-amp-arreston-efektivin-e-policise-ne-durres-nisin-hetimet-per-dy-te-tjere/
BURIMI	radar.al
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	15 shtator 2026, 11:00:26 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 900 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	15 shtator 2026, 10:44:58 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	20ebff674a30a420e9f11467faa50fffd5d761bae681de5123c70f72a969b972
TEKSTI	73d4920870dbde8737878ffb6811e4f9a8e39cc237b947e9e3afb7de77eed070
PAMJA	e15ed1cef39c1d395548725a853b7e5e2e89344308f6bb00d706b15556269fb0

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	57bb4524537a8487f153cc4a94fbbaf221529d550767d7948f80d7ec936058f1
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	93a0feb7bb19154a540f480bce1eeee0b2224e0180d4198842f090d06654d15a
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahajo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/57bb4524537a8487f153cc4a94fbbaf221529d550767d7948f80d7ec936058f1>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

YOU ARE AT: Home » Korrupsion dhe shpërdorim detyre, AMP arreston efektivin e Policisë në Durrës! Nisin hetimet për dy të tjerë

AKTUALITET

Demo

Korrupsion dhe shpërdorim detyre, AMP arreston efektivin e Policisë në Durrës! Nisin hetimet për dy të tjerë

SEPTEMBER 15, 2026



Një efektivi i Policisë në Durrës është arrestuar pas një Operacioni të Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore, ndërkohë për dy të tjerë ka nisur hetimi në gjendje të lirë.

Sipas AMP ndaj efektiveve rëndojnë veprat penale 'Korrupsioni pasiv i personave që ushtrojnë funksione publike' dhe 'Shpërdorimi i detyrës'.

Njoftimi i plotë

Operacioni i Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore ka çuar në arrestimin në flagrancë të një punonjësi të Policisë dhe procedimin në gjendje të lirë të dy efektiveve të tjerë, të dyshuar për korrupsion dhe shpërdorim detyre. Operacioni është finalizuar më 15 shtator 2026, në kuadër të procedimit penal nr. 100/2026, pas një hetimi të zhvilluar me metoda speciale nga Drejtoria Rajonale Durrës-Kavajë, në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të AMP-së, nën drejtimin e Prokurorisë së Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës.

Në përfundim të operacionit është arrestuar në flagrancë efektivi S.M., me detyrë Trupë Shërbimi Patrullë e Përgjithshme.

Ndërkohë, për veprën penale "Shpërdorimi i detyrës" janë referuar në gjendje të lirë edhe dy punonjës të Policisë, S.H., me detyrë Specialist për Rendin në Komisaratin e Policisë Durrës, dhe A.K., me detyrë Trupë Shërbimi Patrullë e Përgjithshme në Komisaratin e Policisë Durrës.

Hetimi është zhvilluar në kuadër të procedimit penal për veprat penale "Korrupsioni pasiv i personave që ushtrojnë funksione publike" dhe "Shpërdorimi i detyrës".

Pas përfundimit të veprimeve procedurale, materialet e përpiluara janë referuar në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, e cila do të vijojë me veprimet e mëtejshme sipas ligjit.

AMP do të vijojë të ushtrojë kompetencat e saj ligjore për evidentimin, dokumentimin dhe goditjen e rasteve të paligjshmërisë, korrupsionit dhe shpërdorimit të detyrës në radhët e punonjësve të strukturave që mbikëqyr.

AMP Arrestohet Durrës Efektivi i policisë korrupsion Shpërdorim detyre

SHARE.

Postimet e reja

Laboratori i heroinës në Has, arrestohet në...

SEPTEMBER 15, 2026

Korrupsion dhe shpërdorim detyre, AMP...

SEPTEMBER 15, 2026

245 aplikime për punë në Agjencinë për Media dhe...

SEPTEMBER 15, 2026

Prespa drejt UNESCO-s! Shqipëria, Greqia dhe...

SEPTEMBER 15, 2026

Mos e humb

FOKUS | SEPTEMBER 15, 2026

Kompania e krijuar tri ditë pas hapjes së thirrjes për grantet e startupeve fitoi 6.1 milionë lekë në fazën e rezervuar për biznese të paktën 1-vjeçare

Pas shpalljes së listës së fituesve të "Grant 2026" kanë nisur të dalin rastet ku...

Skema sesi IUTE zbras fitimin nga Shqipëria, që ju merr konsumatorëve me interesa mbi 30%!

Skandal me sallamin në dyqanet Conad, thirrje konsumatorëve ta kthejnë mbapsht

6 milionë euro të Startup Albania: Përfituesit, qokat dhe "problematikët"

Na ndiq

Facebook

Instagram

RRETH NESH



Një shikim i thellë në botën e lajmeve, ku teknologjia dhe profesionalizmi takohen për të sjellë lajmet më të fundit dhe të rëndësishme brenda dhe jashtë Shqipërisë. Një burim i besueshëm për informacionin e saktë dhe analizat gjithëpërfshirëse.

NIPT: M47705501A

Email: radarlajme@gmail.com

Kontakt: +355689008000

HOROSKOPI

Universi ka një surprizë për këto 3 shenja më 14 shtator

Një ditë me surpriza në dashuri:
Horoskopi për të gjitha shenjat

Pak dramë, shumë ndjenja:
Horoskopi i dashurisë për këtë javë



Aleanca për
Media
Etike

Artikull joetik?

raporto këtu